

## Huazo sigurtë, menqur & thjeshtë

### Si bëhet kjo?

Të huazosh tek ne është sigurtë, menqur dhe thjeshtë. Ti e dorëzon një gjësend si kaucion dhe ne të japim hua parashë menjëherë. Se çfarë shume parashë mund të huazoshë mvaret nga vlera e gjësendit. Përafërshishtë 60 përqindë e vlerës së dorës së dytë është e rëndomtë.

### Çfarë gjësendesh pranohen si kaucion?

Pranohet pothuajse çdo gjë të cilës mund t'ia llogarisim vlerën e dorës së dytë dhe të cilën mund ta mbajmë në lokalet tona. Mund të bëhet fjalë për stoli, margaritarë, orë, elektronikë, enë porcelani, gota, instrumente, argjend, fotoaparate, art dhe gjësende antike. Urdhëroni telefononi dhe ne ua japim vlerësimin e parë.

### Në çfarë afati mund të huazoj?

Normalishtë një huazim zgjatë për gjashtë muaj. Këtë afat mund ta vazhdosh. Në atë rast e paguan kamatën për afatin e shfrytëzuar dhe vazhdon të huazoshë para edhe për një kohë. Nëse dëshiron ta ktheshë huanë, gjë të cilën mund ta bëshë kurdoherë gjatë afatit të huasë, i paguan paratë e huazuara si dhe kamatën për secilin muaj të filluar.

### Ligji dhe rregullat në rast të huamarrjes

Të huazosh është thjeshtë. Duhet të jeshë 18 vjeç dhe të tregosh letërnjoftimin kur huazon dhe kur kthen huanë. Fletëkaucioni është personal dhe nuk mund ti ipet askujt tjetër. Një i dërguar mund ta kthejë huanë nëse të gjitha të dhënat në fletëkaucion janë të plotësuara dhe nëse tregohet edhe letërnjoftimi i të dërguarit edhe ai i huamarrësit. Për huatë vlenë Ligji "Pantbankslagen 1995:1000". Huatë janë të siguruara në përputhje me dispozitat në këtë ligj. Për ti eliminuar rreziqet e përdorimit të gjësendeve të vjedhura ne bashkëpunojmë me policinë.

### Sa kushton?

Huaja deri në 10.000 korona ka një kamatë prej 32,50% në muaj (39% në vit). Pjesa e huasë mbi 10.000 korona kan një kamatë prej 2,5% në muaj (30% në vit).

Shembull: 1000 kr 32,50 kr/muaj

5000 kr 162,50 kr/muaj

10 000 kr 325 kr/muaj

20 000 kr 575 kr/muaj

Tarifa e shërbimeve i shtohet huasë. Kamata llogaritet për secilin muaj dhe çdo muaj i filluar llogaritet si i plotë.

### Çfarë ndodhë nëse nuk kthejë huanë?

Përafërshishtë 95 përqind e të gjitha huave kthehen mirëpo nëse nuk e kthen huanë tënde atëherë kaucioni shitet në ankand publik. Nëse çmimi i shitjes e tejkalon shumë e huasë kuptohet se teprica të takon ty.

### Po qe se dëshiroj të blejë?

Të gjitha gjësendet që ekspozohen në vitrinë janë në shitje. Ne ofrojmë një sortiment të madhë stolishë, margaritarësh, orësh, arti, gjësendeve antike dhe qilimave original. Shpesh mund të lavdërohemi për çmimet më të mira në qytet. Çdo gjë është origjinale. Edhe çmimet.